Kanosi dhe dhunoi gruan, 37-vjeçari nga Kamza hedh armën nga dritarja kur sheh policinë te dera



09:31 - 5 Shtator, 2022

Një 37-vjeçar është arrestuar nga policia në Kamzë, pasi akuzohet se ka dhunuar dhe kanosur bashkëshorten. Në pranga është vënë Marash Mexhaj, 37 vjeç.

Sipas policisë, ky i fundit, mbrëmjen e djeshme ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij dhe e ka kanosur atë. Ndërsa në momentin që kanë arritur shërbimet e Policisë, ka hedhur armën e zjarrit pistoletë nga dritarja e banesës dhe ka tentuar të largohet, por është prangosur nga shërbimet e Policisë.

Njoftimi i plotë:

Kamzë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Kasalla", i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Nr. 5

Falë ndërhyrjes në kohë nga shërbimet e Policisë, u parandalua një ngjarje e mundshme kriminale në familje.

Vihet në pranga 37-vjeçari që ushtroi dhunë ndaj bashkëshortes dhe e kanosi atë me armë zjarri.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë me fishek në fole gati për qitje, municion luftarak dhe 5 radio që dyshohet se lidheshin me valët e radiove të Policisë.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 5, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative se në fshatin Kasallë një shtetas mbante armë zjarri dhe ushtronte dhunë ndaj bashkëshortes, menjëherë kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Kasalla".

Si rezultat i tij u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

– M. M., 37 vjeç, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Dhuna në familje".

Shtetasi M. M., mbrëmjen e djeshme ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij dhe e ka kanosur atë. Ky shtetas në momentin që kanë arritur shërbimet e Policisë, ka hedhur armën e zjarrit pistoletë nga dritarja e banesës dhe ka tentuar të largohet, por është prangosur nga shërbimet e Policisë.

Gjatë kontrollit përreth banesës, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë me fishek në fole gati për qitje. Po gjatë kontrollit në banesë, Policia gjeti dhe sekuestroi municion luftarak, një këllëf pistolete si ato të Policisë dhe 5 radio që dyshohet se lidheshin me valët e radiove të Policisë.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

#angazhimpërkushtimsakrificë👮‍♂️🚔
#tëvendosurkundërkrimit✅
#nëçdoskajtëvendit🇦🇱
#nëshërbimtëqytetarëve👮‍♂️🤝👮‍♀️

/abcnews.al

*Anash Aktualitet

Të ngjashme

Tensionet në veri të Kosovës, mbyllet protesta e serbëve në Jarinjë

Ceremonia e përmbylljes së Botërorit

Ulja e inflacionit, qeveria optimiste për rritjen ekonomike, 4.1 % në 2022

Minute pas minute

15:37
Tensionet në veri të Kosovës, mbyllet protesta e serbëve në…

15:34
Ceremonia e përmbylljes së Botërorit

15:32
Ulja e inflacionit, qeveria optimiste për rritjen ekonomike, 4.1…

15:29
Si të pastroni pluhurin në vendet më të paarritshme në…

15:27
Benzema inkurajon të tijët: Tani është momenti, të gjithë…

ARKIVOJA PËR ETIKË ARTIKULL JOETIK?

15:37 - 18 Dhjetor, 2022
Tensionet në veri të Kosovës, mbyllet protesta e serbëve në Jarinjë

15:34 - 18 Dhjetor, 2022
Ceremonia e përmbylljes së Botërorit

15:32 - 18 Dhjetor, 2022
Ulja e inflacionit, qeveria optimiste për rritjen ekonomike, 4.1 % në 2022

15:29 - 18 Dhjetor, 2022
Si të pastroni pluhurin në vendet më të paarritshme në shtëpinë tuaj

15:27 - 18 Dhjetor, 2022
Benzema inkurajon të tijët: Tani është momenti, të gjithë bashkë drejt trofeut

15:20 - 18 Dhjetor, 2022
Rusia do të dërgojë muzikantë në frontin e luftës për të rritur moralin…

15:10 - 18 Dhjetor, 2022
Achraf Hakimi flet pas "zënkës" me Infantinon: Isha i zemëruar, pas…

15:09 - 18 Dhjetor, 2022
Pse ish-futbollistët janë më të rrezikuar nga plakja e parakohshme dhe…

ABC NEWS AL
info@abcnews.al
+355 67 400 9040

Rreth nesh

Abcnews.al është website kryesor i lajmeve në Shqipëri. Pjesë e televizionit ABC, redaksia e Abcnews.al ka të shenjtë verifikimin e lajmit në mënyrë të pavarur nga gazetarët tanë para publikimit. Me një redaksi të riorganizuar, Abcnews.al mundëson një mbulim të plotë të zhvillimeve më të fundit nga vendi dhe bota, përmes një stafi të kualifikuar dhe profesional. Saktësia në informim mbështetet edhe me risitë më të fundit në lidhje me mediat online duke e bërë Abcnews.al një media avangardë në vend. NUIS/NIPT K01711004F

| "Cash" | Privacy | Kushtet e Përdorimit |

Harta e faqes

Aktualitet
Politikë
Rajon
Sport
Botë
Ekonomi
Emisione
Moti
English
Life
Plus

Copyright © 2022 ABC NEWS. All rights reserved.